

**VENDIM**  
**Nr.212, datë 16.3.2011**

**PËR DISA SHTESA DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.107, DATË 10.2.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR BOTIMIN, SHTYPJEN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, 56 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 8 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërve”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.107, datë 10.2.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ky ndryshim:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Shtëpia Botuese e Librit Universitar (SHBLU) dhe shtëpi të tjera botuese ngarkohen me botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të pakicave kombëtare, të klasave I deri IX, dhe të teksteve të arsimit profesional. Shtypja e këtyre teksteve të realizohet në SHBLU dhe në shtypshkronja të tjera.

Çmimi i këtyre teksteve miratohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Mënyra e shpërndarjes së tyre përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.”.

b) Pika 6.4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6.4. Për tekstet shkollore të pakicave kombëtare, nga klasa I deri IX, dhe për tekstet shkollore të fëmijëve të familjeve të emigrantëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, çmimi i blerjes të mbulohet në masën 100 për qind, me fondet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.”.

c) Pas pikës 6.4 shtohen pikat 6.5, 6.6, 6.7 dhe 6.8, me këtë përmbajtje:

“6.5. Për tekstet shkollore të fëmijëve të familjeve të emigrantëve, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, procedura e blerjes së tyre realizohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, kundrejt procedurave të konkurrimit të hapur me shtëpitë botuese. Procesi i botimit, i shtypjes, i shpërndarjes dhe i shitjes së teksteve shkollore të arsimit parauniversitar bëhet nga shtëpitë botuese.

6.6. Ministria e Punëve të Jashtme, në bashkëpunim me selitë diplomatike në këto vende, dërgon në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, brenda muajit maj të çdo viti, kërkesën për tekste shkollore, të detajuar sipas grup-moshave të fëmijëve të familjeve të emigrantëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës dërgon në Ministrinë e Punëve të Jashtme, brenda muajit gusht të çdo viti, sasinë e teksteve shkollore të porositura.

6.7. Për tekstet shkollore të fëmijëve romë, nga klasa I deri IX, çmimi i blerjes së tyre të mbulohet 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës romë, duhet të dorëzojnë në DAR/ZA-të përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie. Mënyra e shpërndarjes së teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

6.8. Nxënësit që gëzojnë statusin e të verbrit, të cilët mësojnë në klasat I deri IX, pajisen me tekste shkollore të transkriptuara në shkrimin brail, të regjistruara në audio ose në shkrim të zmadhuar. Çmimi i blerjes së këtyre teksteve të mbulohet 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Këto tekste shkollore janë pronë e shkollës dhe afati i përdorimit të tyre

mund të variojë nga dy deri në tre vjet.”.

ç) Pas pikës 8 shtohet pikat 8/1, me këtë përmbajtje:

“8/1. Administrimi i kërkesave për prodhimin/shumëfishimin e teksteve në brail dhe në shkrim të zmadhuar literal, si dhe pajisja me libra e nxënësve të verbër të realizohen nga Instituti i Nxënësve që nuk Shikojnë, në Tiranë. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës të verbër, duhet të dorëzojnë në DAR/ZA-të përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

3. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Sali Berisha**